



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr. 526/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Kosova Adalet Turk Partisi (KATP), me seli në Prizren, ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajtura më datë 09.01.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

HEDHET e palejuar ankesa A.nr.526/2025, e datës 10.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik Kosova Adalet Turk Partisi (KATP), me seli në Prizren, ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajtura më datë 09.shkurt.2025.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 10.02.2025, ka pranuar ankesën Anr.526/2025, nga subjekti politik Kosova Adalet Turk Partisi (KATP), me seli në Prizren, në të cilën pretendon se pas publikimit të rezultateve të datës 10 Shkurt 2025, sipas vëzhgimeve të vëzhguesit të partisë tone, s'janë barabartë nënshkrimet dhe fletëvotimet në vendvotimin numër 3201/5 në Komunën e Mamushës. Po ashtu parashtruesi i ankesës kërkon rinumërim të votave në vendvotimin 3201/5 në Komunën e Mamushës.

Në përgjigjen në ankesë të datës 11.02.2025 nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), theksohet se bazuar në Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës neni 102 paragrafi 5 ka bërë përmbledhjen e rezultateve preliminare (paraprake) të vendvotimeve dhe i bën publike përmes platformës elektronike me datën 10.02.2025. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të ndryshohen, korrektohen dhe plotësohen, nga Qendra Komunale e Numërimit (QKN) dhe Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), e cila mundëson në evitimin e çdo gabimi teknik pas publikimit të rezultateve përfundimtare të këtyre zgjedhjeve nga KQZ-ja.

Bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. Prandaj, bazuar në nenin 105.1 të

Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Pala ankuese, nuk e ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk janë specifikuar arsyet e mospërputhjes me ndonjë dokument siç janë, vëzhguesit e akredituar, Formularët e Rezultateve të Subjekteve politike etj.

Bazuar në dispozitat ligjore në Ligji nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, gjegjësisht neni 119 i LZP-së përcakton se: PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj, në nenet 27.6, 39,3, 41, 54.6, 51.4 54.8, 69.7, 77.5 80,3, 94.2, 98.3, 100.3 102.1, 103.4 dhe neni 105.1. Nga interpretimi i dispozitave ligjore Ligji Nr.08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit Nr. 03/ L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës nuk parashihet me asnjë dispozite ligjore se mund të ankimohen rezultatet preliminare të kësaj natyre të KQZ-së, nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP. Nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura në këtë përgjigje, pretendimet e palës ankuese nuk kanë asnjë bazë ligjore dhe nuk janë të mbështetura nga ndonjë provë e qartë dhe bindëse.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohen parregullsive në ditën e votimit, për shkak se përmes kësaj ankese atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimeshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrahet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.


Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105.1 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Bazuar në arsyet e sipërsënuara dhe në kuptim të neni 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Neni 13.3 të Rregullores Nr.01 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim.”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesave të palejueshme nuk e prejudikon rezultatin përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe 13.3 Rregullores Nr.01 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 526/2025 më datën 12.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas **nenit 118 paragrafi 4** të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.